

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 27.3.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘DRINI BULQIZË’ sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65, datë 16.4.2024, bëhen korrigjimet si më poshtë:

Titulli ishte:

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Titulli bëhet:

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR LICENCIMIN NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Si dhe korrigjimi i veprimtarisë së licencimit në relacionin e cituar të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes si më poshtë:

Ishte:

“Mbi kërkesën e shoqërisë ‘DRINI BULQIZË’ sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”

Bëhet:

“Mbi kërkesën e shoqërisë ‘DRINI BULQIZË’ sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”